



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2023:074964

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05760428

**P.nr.86/2023**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Bytyqi, në çështjen panele ndaj të akuzuarve, D.G., dhe I.Rr., nga fsh. Duhël komuna Suharekë, për shkak te veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, nr.06L-074, iniciuar sipas aktakuzës PP/II.nr. 176-12/2023 të dt. 23.03.2023, jashtë seancës, me dt. 31.05.2024 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Prizren – Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr. 176-12/2023 të dt. 23.03.2023, PUSHON procedura penale ndaj të akuzuarve, D.G., dhe I.Rr., nga fsh. Duhël komuna Suharekë, për shkak te veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, nr.06L-074, gjykata sipas detyrës zyrtare ne pajtim me dispozitat ligjore ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, në të cilën seancë të akuzuarit kan propozuar që të aprovohet kërkesa e tyre, në mënyrë që kjo çështje penale të zgjidhet në procedurën e ndërmjetësimit. Prokurori i shtetit nuk e kundërshton propozimin e të akuzuarve.

Pas pranimit të propozimit të të akuzuarve dhe pas marrjes se mendimit te Prokurorit të Shtetit dhe të dëmtuarit, gjykata ka marre aktvendim dhe ka aprovuar kërkesën e të akuzuarve, me ç, rast të gjitha shkresat e lëndës ia ka dorëzuar institucionit të ndërmjetësimit, të cilët kanë sugjeruar në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmjetësim.

Me dt. 30.05.2024 ne institucionin për Ndërmjetësim, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e rastit ku është arritur marrëveshja, pajtimi rreth kësaj çështje ne mes të akuzuarve dhe të dëmtuarit. Të akuzuarit kërkojnë falje dhe premtojnë se në të ardhmen nuk do të përsërisin veprime të tilla kundërligjore.

Palët pa ndonjë kërcenim dhe me vete dëshirë kanë shprehur gatishmëri që kjo çështje të zgjidhet dhe nuk kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura, shprehur në vendimin Ndm.nr. 19/24 të dt. 30.05.2024 dhe kjo marrëveshje e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

Gjykata duke u bazuar ne provat si më larte dhe në bazë të nenit 357 par. 1 nen par. 1.3 të KPPRK-së, dhe nenit 12 par. 12.5 te Ligjit për ndërmjetësim, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktvendimi.

Gj y q t a r i  
Qemail Suka

**KESHILLA JURIDIKE;** kundër këtij aktvendimi palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditëve Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pas marrjes së të njëjtit nëpërmjet kësaj Gjykate.